

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“FINEUS“ SH.P.K



Sot me date 06-09-2022 ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 dhe te ligjit nr.9723 date 03.05.2007 une i nenshkruari.

Z. Ales Zpevak atësia Bohuslav amësia Dana, lindur në datë 12/06/1984 në Pardubice të Çekisë, pajisur me pasaportë të Republikës Çeke me Nr. 45533169 dhe numër personal 84061213330, themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.) te emertuar “ FINEUS“ sh.p.k

NENI 1

Emertimi i shoqerise

Shoqeria e ka emrin “FINEUS” sh.p.k ne perputhje te plote me vullnetin e themeluesit te saj.

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin vendodhjen, objektin e veprimtarise dhe kohezgjatjen e saj ne perputhje me vullnetin dhe vendimet qe do te marrin ortaket themelues te saj.

Emri i plote i shoqerise do te jete “FINEUS SH.P.K”.

Neni 2

Qëllimi dhe Fusha e Veprimtarise

Shoqeria “FINEUS SH.P.K” ka si qellim kryesor:
Menaxhimi i projekteve në fushën e energjisë. Studime dhe kërkime shkencore në fushën e energjetikës dhe në fusha të tjera që kane lidhje me të.
Dhënia e konsulencës dhe asistencës teknike, për investimet në fushën e energjetikës.

Neni 3

Forma e Shoqerise

“**Shoqeria FINEUS SH.P.K**” është organizuar në formën e një shoqerie, fitimprurëse, joqeveritare, jopolitike, të pavarur, duke ushtruar veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga organet dhe interesat shtetërore.

Neni 4

Vula e Shoqerise

Shoqeria do të ketë vulën e saj e cila do të identifikojë çdo dokument që i përket shoqerise.

Përdorimi i vulës fillon që nga data e fitimit të personalitetit juridik të shoqerise.
Vula e shoqerise njihet dhe pranohet nga të tretët duke filluar nga data e regjistrimit te saj .

Forma e vules se shoqerise i bashkangjitet statutit, si pjese perberese e tij dhe eshte e firmosur nga anetari themelues i shoqerise .

Neni 5

Ndalimi i shpërndarjes së fitimeve

Të ardhurat nga aktiviteti i ligjshëm i Shoqërisë do të përdoren ekskluzivisht për zhvillimin dhe realizimin e qëllimeve të kësaj shoqërie.

Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e shoqërisë prej personave që janë subjekte të statutit dhe aktit themelues.

Neni 6

Ushtrimi i Aktivitetit

Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj brenda teritorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Kohëzgjatja

Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj në një kohëzgjatje të pacaktuar.

Neni 8

Selia

Selia e shoqërisë do të jetë në qytetin e Bilishtit Bashkia Devoll, Lagjia nr. 5, Superstrada e Devollit, zona kadastrale 1187, me sipërfaqe 40M2.

Neni 9

Struktura e brendëshme dhe funksionimi i shoqërisë

Shoqëria do të ketë organet e veta drejtuese të cilat janë si më mëposhtëme:

- Asambleja e ortakëve.
- Administratori i shoqërisë.

Menyra e emerimit dhe caktimit të personave që do të përbejnë këto organe, si dhe kompetencat e tyre caktohen në statutin e shoqërisë.

Neni 10

Administratori i Shoqërisë

Administratori i shoqërisë "FINEUS SH.P.K" është zgjedhur **Ales Zpevak** atësia Bohuslav amësia Dana, lindur në datë 12/06/1984 në Pardubice të Çekisë, pajisur me pasaportë të Republikës Çeke me Nr. 45533169 dhe numër personal 84061213330, i cili autorizohet të ndjeke të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e këtij subjekti

Neni 11

Akti i themelimit të shoqërisë "FINEUS SH.P.K" nënshkruhet nga themeluesi.

Themeluesi i Shoqërisë

"FINEUS" shpk

Ales Zpevak

ALES ZPEVAK

